



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2624 Prot.

Durrës, më 18.12 2024

VENDIM
Nr. 79, datë 18.12 2024

"PËR MIRATIMIN E NJË SAKTËSIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.52, DATË 04.11.2024 "PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE DOKTORATË NË "DIDAKTIKË E GJUHËVE TË HUAJA" PRANË DEPARTAMENTIT TË GJUHËVE TË HUAJA, NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës" ME UNIVERSITETIN "CONSTANTINE THE PHILOSOPHER UNIVERSITY" NITRA, SLOVAKI

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020" Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik nr.56, datë 17.12.2024, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e një saktësimi në Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.52, datë 04.11.2024, pika 1, bëhet: Miratimin e tarifës së programit të përbashkët (diplomë e dyfishtë) të ciklit të tretë të studimeve doktoratë në "Didaktikë e Gjuhëve të Huaja" pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, me Universitetin "Constantine the Philosopher University" Nitra Slovakia sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim i bashkëlidhet Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 52, datë 04.11.2024.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtuesi i Njësive Kryesore Fakulteti i Edukimit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

